



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.01 Date 17.06. 2010

Per

Perfshirje ne Planin e Menaxhimit te Basenit Mat te lumit Drin Lezhe si pike e nxehte me ndotje ambientale te madhe dhe ngritjen e sistemit te monitorimit per matjen e erozionit malor dhe shkalles se sigurise se argjinaturave ne lumenjte Mat dhe Drin Lezhe.

Ne mbeshtetje te neni 8, 14,38ligjit nr.8093 date 21.03.2006 “Per rezervat ujore”, vendimeve te tjera te K.K.Ujit ne zbatim te ligjit “Per rezervat Ujore” u shqyrtua raporti AUB Mat mbi propozimet e bera per tu perfshire ne Planin e Menaxhimit te Basenit Mat te:

I. Lumit Drin Lezhe i cili ne mbi 300 dite eshte nje kanal pa ose me pak uje, periudhe kjo qe e kthen ate ne nje vater ndotje me pasoja per popullsine. Ky lum mbas 6 ore qe perfundojne reshjet e kapercen ploten maksimale dhe prurjet bien gradalisht deri ne 5 m³/sek. Ne kete moment eshte e nevojshme qe te leshohet uje nga Drini i Shkodres i cili sjell tri ane pozitive:**a.Lumi Drin i Lezhes behet i paster nga vetrrjedhje, b. Gryka e derdhjes ne det qendron e zhbllokuar gjithnje dmth ndikojme pozitivisht ne eliminimin e permbytjeve ne Lezhe, c.Ulet kercenimi per permbytje nga Drini Shkoder perse pikerisht kur fillojne shkarkimet nga H/C, Drini Lezhe e ka kaluar ploten max dmth mundet qe te japim uje atij pra te heqim uje nga permbytjet ne Shkoder.**

II. Lumi Mat ne zonen fushore furnizohet me inerte nga erozioni malor. Ne se nuk hiqen ato do te kemi rrezik per permbytje dhe ne se heqim me shume do te kemi pasoja ne brigje, ura, argjinatura dhe brigjet e detit. Ngritja e nje sistemi hidrometrik do te ndihmonte ne vleresimin real te sigurise se argjinaturave, ne nivelin e erozionit malor,ne vleresimin e dinamikes se shtratit te lumit dhe ne ruajtjen e nje biodiversiteti te domosdoshem. Kjo vlen edhe per lumin Drini Lezhe.

III.Projekti Zhvillimit te burimeve Natyrore per 5 vite me radhe ka aplikuar direkt ne mikrosenet qe kane lidhje me Basenin e Matit me projekte qe kane te bejne me uljen e nivelit erozionit nepermes pyllzimeve, pritave malore, pastrimit te pyjeve etjere. Per te gjitha komunat ka plane nderhyrjeje per 10 vitet e ardhshme. Ne 8 Komuna ne kete basen jane hartuar Plane te hollshme mikrobaseni duke e

konceptuar nje mikrobasen sipas njesise administrative. Ky fakt dhe te tjera jane informacione per shkallen e erozionit dhe masat e planifikuara per 10 vjecarin e ardhshem jane pike orientimi per nderhyrje te metejshme me investime nga PZHBN dhe institucione te tjera jo dhe qeveritare. Ulja e shkalles erozionit nga keta investime tashme eshte fakt por duhet te monitorohet se sa eshte kjo ulje per sa lek te shpenzuara etjere.

IV. Komuna Mnele-Vig duhet perfshire ne Basenin Mat me qene se ujrat e kesaj zone derdhen ne lumin Drini i Lezhes. Kjo vlen edhe per Qafe Shtamen e cila i perket si Nj. Administrative krujes por uji rrjedh ne lumin Mat si dhe ana veri-perindimore e Lures uje i te ciles rrjedh ne lumin Mat. Nga diskutimet, **Keshilli i Basenit Mat,**

V E N D O S I

1-T'i propozohet Ministrise Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit Ujrave qe ta vleresoje lumin Drini Lezhe si nje pike kryesore te nxehte me ndotje te larte ambientale, me pasoja per nje zone me popullsine me te dendur te ketij baseni.

2. T'i propozohet Ministrise Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit Ujrave qe te perfshije ne Planin e Menaxhimit monitorimin e erozionit malor, sigurine e argjaturave, biodiversitetin etjere **me ngritjen e nje sistemi hidrometrik per lumenjte fushor Mat dhe Drini lezhe.**

3. Te hartohet Plan i perbashket per monitorimin dhe vlersimin e erozionit dhe masat perspektive me Planin e Zhvillimit te Burimeve Natyrore (PZHBN) ne nivele mikrobasesh.

4. Te konsiderohet studimi i lumit Drin Lezhe i bere nga Akademise Shkencave ne bashkpunim me Ministrine e Bujqesise dhe me Keshillin e Qarkut Lezhe per nje lum Drini Lezhe i rrjedhshem, me uje te paster, turistik, me flore dhe faune te pasur.

5. Te perfshihet edhe Komuna Mnele-Vig. Krej Lura dhe Qafe Shtama ne projektin e Planit te Menaxhimit te Basenit Mat.

6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT

Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT

Pal DAJCI

